



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1462/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Doni Fruits” ShPK, me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCRL Partners”, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit “Lux” ShPK me seli në Lipjan, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Nebih Troshupa avokat nga Lipjani, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1251/22 të datës 20.09.2023, me datë 04.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit “Doni Fruits” ShPK, me seli në Ferizaj, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1251/22 i datës 20.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1251/22 të datës 20.09.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit ‘Lux’ ShPK me seli në Lipjan, ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr.261/21 i lejuar me datë 27.04.2021, nga përmbaruesi privat Besnik H. Aliu anulohet dhe ka detyruar kreditorin që në emër të shpenzimeve për përpilimin e prapësimit, t’ia paguaj debitorit shumën e përgjithshme prej 312.00€.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit të procedurës përmbarimore, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e kreditorit, të anulohet në tërësi si i pabazuar aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1251/22 i datës 20.09.2023, ashtu që lënda i kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, ose ndryshohet në tërësi aktvendimi i atakuar, ashtu që refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Lux” ShPK i parashtruar kundër urdhrit për përmbarim të përmbaruesit Privat Besnik Aliu me numër P.nr.261/21 të datës 27.04.2021 dhe mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor i Përmbaruesit Privat Besnik Aliu me numër P.nr.261/21 të datës 27.04.2021.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar me propozim që Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, Departamenti për Çështje Ekonomike ta refuzojnë ankesën e kreditorit dhe ta obligoj që t'i paguaj shpenzimet lidhur me përgjigjen në ankesë në vlerë prej 312.00€.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Doni Fruits” ShPK, me datën 27.04.2021 ka paraqitur propozim për lejimin e përbarimit, kundër debitorit “Lux” ShPK me seli në Lipjan, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave për shumën e borxhit prej 89,317.14€.

Përbaruesi Privat Besnik Aliu, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Doni Fruits” ShPK ka caktuar urdhrin P.nr.261/21 të datës 27.04.2021 duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturave: Faturë nr. 0332/2020, e datës 14.05.2020; Faturës nr. 0057/2020, e datës 23.02.2020; Faturës nr. 0557/2020, e datës 03.07.2020; Faturës nr. 0474/2020, e datës 16.06.2020; Faturës nr. 0469/2020, e datës 15.06.2020; Faturës nr. 0320/2020, e datës 12.05.2020; Faturës nr. 0268/2020, e datës 30.04.2020; Faturës nr. 0221/2020, e datës 19.04.2020; Faturës nr. 0194/2020, e datës 11.04.2020; Faturës nr. 0197/2020, e datës 07.04.2020; Faturës nr. 0172/2020, e datës 05.04.2020; Faturës nr. 0165/2020, e datës 03.04.2020; Faturës nr. 0149/2020, e datës 29.03.2020; Faturës nr. 0139/2020, e datës 26.03.2020; Faturës nr. 0127/2020, e datës 19.03.2020; Faturës nr. 0117/2020, e datës 17.03.2020; Faturës nr. 0115/2020, e datës 16.03.2020; Faturës nr. 0102/2020, e datës 12.03.2020, si dhe; Faturës nr. 0085/2020, e datës 06.03.2020, me të cilin është urdhëruar debitori që pas pranimit të urdhrin t’ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 89,317.14, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e arritjes së kërkesës për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1251/22 të datës 20.09.2023 me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Lux” ShPK me seli në Lipjan dhe e ka anuluar urdhrin përbarimor P.nr.261/21, të datës 27.04.2021, të lejuar nga Përbaruesi Privat Besnik Aliu.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme, për arsye se faturat në fjalë janë lëshuar në emër të një subjekti tjetër nga këtu debitori. Përkatësisht, faturat të cilat i janë bashkangjitur propozimit për përbarim janë lëshuar në emër të subjektit Top Fruit di Angela Colucci & C.S.a.S., ndërsa propozimi për përbarim është ushtruar ndaj Lux Sh.P.K., këtu debitor. Në këtë drejtim, gjykata gjen se këtu kreditori nuk është i autorizuar që në këtë procedurë të kërkojë përbarimin ndaj debitorit, për arsye se në dokumentet mbi bazën e së

cilave është lejuar urdhri si debitor është i shënuar një person tjetër nga këtu debitori i përmbartimit “Lux” Sh.P.K.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimit të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike kur ka konstatuar se faturat të cilat i janë bashkangjitur propozimit për përmbartim janë lëshuar në emër të subjektit Top Fruit di Angela Colucci & C.S.a.S., ndërsa propozimi për përmbartim është ushtruar ndaj Lux Sh.P.K., këtu debitor. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par.3 i LPP, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes se detyrimit monetar”*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbartimore, respektivisht është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet në mënyrë komulative qe duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret është edhe qëndrim i kësaj gjykate se qartë rezulton se faturat janë lëshuar në emër të një subjekti tjetër nga këtu debitor, ashtu që propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet nga Neni 29 dhe 37 i LPP-së.

Rrjedhimisht, kjo gjykatë vlerëson se nisur nga fakti se procedura përmbartimore paraqet procedurë formale që i nënshtrohet shqyrtimit formal të dokumenteve përmbartimore dhe/apo atyre të besueshme, rrjedh se si kusht esencial mbi bazën e së cilës mund të lejohet përmbartimi janë tiparet e përmbartueshmërisë së dokumentit të besueshëm e të cilit në rastin konkret i mungojnë kushtet nga Neni 29 par.3 dhe 37 i LPP-së. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbartues sepse rezulton se debitori nuk e ka pranuar detyrimin, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përmbartimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përmbartimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të se drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1462/23 datë 04.06.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha